

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Përgjegjës Rajonal** pranë OSSH / Departamenti i Kontrollit dhe Rekuperimit të Humbjeve / Njësia Rajonale e Kontrollit dhe Rekuperimit të Humbjeve / DKRH Rajon.

PËRGJEGJËS RAJONAL

Të drejtojë dhe koordinojë aktivitetet rajonale për parandalimin, identifikimin dhe rekuperimin e humbjeve tregtare të energjisë elektrike, duke garantuar zbatim të ligjshmërisë, integritet institucional dhe përmirësim të performancës operationale.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Analizon balancat e energjisë, leximet dhe faturimet për të identifikuar humbje dhe parregullsi.
- Organizon dhe mbikëqyr inspektimet për zbulimin e vjedhjes së energjisë dhe ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet.
- Identifikon dhe dokumenton rastet me dëm ekonomik sipas rregulloreve të ERE dhe ndjek procedurat përkatëse (administrative ose penale).
- Përgatit plane pune ditore/mujore për ekipet e kontrollit dhe monitoron performancën e tyre.
- Siguron llogaritjen e saktë të dëmit ekonomik (kWh dhe Lek).
- Harton raporte mujore mbi gjetjet dhe humbjet e rikuperuara.
- Raporton rastet e korrupsionit ose shkeljeve tek Auditimi i Brendshëm.
- Bashkëpunon me Auditimin Operacional dhe përfaqëson institucionin në procese gjyqësore kur kërkohet.
- Garanton respektimin e rregullave të sigurisë në punë dhe etikës profesionale.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Diplomë universitare (preferohet Inxhinieri Elektrike / Energji).
- Minimum 3 vite eksperiencë (audit, hetim ose fusha të ngjashme përbëjnë avantazh).
- Aftësi analitike dhe njohuri shumë të mira në Excel.
- Njohuri mbi legjislacionin dhe rregulloret e sektorit energjetik.
- Integritet, aftësi organizative dhe komunikimi.
- Patentë drejtimi.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.